



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1652/ 12 Prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 900/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.852/2026, datë 23.06.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.

Ankimues:

Operatori ekonomik “HEST” sh.p.k, me Nipt, L21527009H, me adresë: Tirane /Mezes Nr 440/124 Zk 2679 volumni 14.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, me adresë: L. Tre Heronjte, Rr. Marin Biçikemi, Shkodër,
Dpmop@bashkiashkoder.gov.al

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 23.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 852/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Hest ” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.*
 - 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
 - 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve të njoftojë Komisionit të Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori “Hest” shpk.*
 - 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

I.2. Me shkresën nr. 554 prot., datë 26.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1652/9 prot., date 19.06.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, njofton se ka bërë rivlerësimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi, si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 554 prot., datë 26.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1652/9 prot., date 19.06.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, njofton se ka bërë rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi, si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit për rivlersimin e ofertave të paraqitura, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin Nr. 852/2026, datë 23.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu